
	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E SUHAREKËS OPSTINA SUVA REKA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA	
---	--	---

Nr: 38/2024	Nr: Protokoli: 66/2024
Për:	Biolab SHPK, Rr.Idriz Seferi nr.265 me adresë në Prishtinë
Nga:	Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit: Fatos Kuqi
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës -Refuzohet
Datë:	16.07.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës në mbështetje të nenit 108/A paragrafi 10.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim**, të parashtruar me datë: 12.07.2024 nga Operatori Ekonomik: **:Biolab SHPK, Rr.Idriz Seferi nr.265** me adresë në Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **:Blerja dhe pajisja me aparatura te nevojshme për QKMF Rexhep Kuqi - 2 lot - Lot 1 Furnizim me pajisje te përgjithshmemjekësorë, - Lot 2 Furnizim me pajisje Stomatologjike dhe laboratorikeme** Numër të prokurimit:624-24-4917-1-2-1Numër i brendshëm624-24-45-121 nxjerr këtë:

VENDIM

REFUZOHET Kërkesa për Rishqyrtim e parashtruar nga Operatori **Biolab SHPK, Rr.Idriz Seferi nr.265** me adresë në Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **: Blerja dhe pajisja me aparatura te nevojshme per QKMF Rexhep Kuqi - 2 lot - Lot 1 Furnizim me pajisje te përgjithshmemjekësore - Lot 2 Furnizim me pajisje Stomatologjike dhe laboratorike** me Numër të prokurimit:624-24-4917-1-2-1Numër i brendshëm624-24-45-121 kundër: (NJOFTIMIT PER KONTRATE TE AK) , të datës 01.07.2024 të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

- I. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit te lartcekur.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Biolab SHPK, Rr.Idriz Seferi nr.265 me adresë në Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:
: **Blerja dhe pajisja me aparatura te nevojshme për QKMF Rexhep Kuqi - 2 lot - Lot 1 Furnizim me pajisje te përgjithshmemjekësore, - Lot 2 Furnizim me pajisje Stomatologjike dhe laboratorikeme** Numër të prokurimit:624-24-4917-1-2-1 Numër i brendshëm: 624-24-45-121
Kundër (NJOFTIMIT PER KONTRATË TE AK) , të datës: 01.07.2024 të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 12.07.2024 sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, me pretendimin ankimor se mos ndarja në një Lot të veçante e pajisjeve Hematologjike kufizon konkurrencën dhe se ky Lot duhet të ndahet nga Lot 2 (**Furnizim me pajisjeStomatologjike dhe laboratorike**)

Përgjigjeje ndaj pretendimit ankimor

- Aktiviteti i prokurimit është i ndarë në dy Lote, përkatësisht Lot 1 Furnizim me pajisje te përgjithshmemjekësore, - Lot 2 Furnizim me pajisje Stomatologjike dhe laboratorike siç edhe ju e potenconi në Kërkesën për Rishqyrtim. Në Lot 2 janë të përfshira pajisjet stomatologjike dhe laboratorike gjë që sipas informative nga njësia e kërkesës ka kompani të mjaftueshme (pra nuk ka ulje të konkurrencës) që iposendojnë të dyja pajisjet (pajisjetlaboratorike dhe stomatologjike) Për më tepër ky aktivitet i Prokurimit ka të bëjë me furnizim dhe jo shërbim ose punë dhe gjithashtu sipas nenit 71 të LPP-ës Operatorët Ekonomik për ta plotësuar njëri tjetrin kane mundësi krijim të GOE (konzercium)

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtım me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

